



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 13 qershor 2012, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

P R O C E S V E R B A L
I M B L E D H J E S S Ë K O M I S I O N I T P Ë R S H Ë N D E T Ë S I, P U N Ë
D H E M I R Ë Q E N I E S O C I A L E

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi, Sasha Gjokiq, Liburn Aliu.

Munguan: Flora Brovina, Salihe Mustafa, Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi; Florie Kryeziu- UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka- kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 30.05.2012;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për shëndetësi, para miratimit në parim;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat;
5. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 30.05.2012

Kryesuesi konstatoi se procesverbali nga mbledhja e datës 30.05.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për shëndetësi, para miratimit në parim

Fikrim Damka- Deklaroi se Projektligji për shëndetësi u është shpërnadarë deputetëve. E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Time Kadriaj- Tha se në këtë Projektligj kam disa vërejtje, të cilat do t'i them në seancë dhe gjatë amendamentimit të tij. Jam për miratimin në parim të këtij Projektligji.

Bahri Thaçi- Tha se e mirëpret ardhjen e këtij Projektligji. Duhet të miratohet ky ligj dhe në këtë mënyrë shëndetësia të zhvillohet në baza të shëndosha.

Nazane Breca- Tha se në këtë Projektligj ka gjëra të paqarta. Megjithatë, unë jam për miratimin e tij në parim.

Liburn Aliu- Tha se ky Projektligj është dashur të vijë bashkë me Projektligjin për sigurimin shëndetësor. Kjo është njëra arsye për të cilën do të votoja kundër. Megjithatë, unë do të abstenoj.

Sasha Gjokiq- Tha se pajtohem që ta miratojmë në parim. Grupi ynë do të japë kontributin në amendamentimin e këtij Projektligji.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi me shumicë votash ta miratojë Projektligjin për shëndetësi, para miratimit në parim.

Komisioni, po ashtu, u pajtua që ta ketë një takim me ministrin e Shëndetësisë për këtë Projektligj.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat

Fikrim Damka- Tha se grupi i punës ka punuar në këtë Projektligj.

Time Kadriaj- Shprehu habinë se përse është vendosur ky Projektligj në rend dite, pasi që kemi pasur për ta shqyrtuar ende këtë Projektligj.

Sasha Gjokiq- Tha se kemi pasur një takim për këtë Projektligj. Jam i gatshëm ta mbajmë një takim të grupit të punës për këtë Projektligj, në mënyrë që ta përfundojmë amendamentimin e tij.

Pas konsultimeve, Komisioni vendosi ta shtyjë këtë pikë të rendit të ditës.

5. Të ndryshme

Fikrim Damka- E njoftoi Komisionin që ka pasur takim me ministrin e MPMS-së. Është vendosur që të mbahet një takim në muajin gusht. Jam takuar edhe me sindikatat. Do ta kemi një takim të premtën për këtë çështje, për të cilën do t'u informoj.

Liburn Aliu- Sa i përket Ligjit të pensioneve, propozimi ynë ka qenë se për këtë çështje janë dy faza: faza emergjente dhe ajo afatgjate. Rekomandimi ynë konsiston që të paguhen këto 21 euro.

Bahri Thaçi- Tha se ka praktika që janë bërë rritje edhe pa ligj, por vetëm me një vendim të Kryeministrit.

Time Kadriaj- E kemi një ftesë për një vizitë në Maqedoni. Propozoj që të dakordohemi që këtë vizitë ta bëjmë në muajin korrik.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka